



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.999/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Orchide Flower” shpk, me numër unik identifikues 811312727 me seli ne Prishtinë rr.” Richard Holbruk” kundër debitorit “Andi Group 2004” shpk, me numër unik identifikues 81291046 me seli ne Gjilan rr.”Abdullah Tahiri” nr.170, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdulla Gashi avokat ne Gjilan, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesat e debitorit, te paraqitura kundër aktvendimeve të Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1198/23 dt.15.01.2024 dhe KPPP.nr.1198/23 dt.14.03.2024, me datën 29.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si te pabazuara ankesat e debitorit “Andi Group 2004” shpk, me numër unik identifikues 81291046 me seli ne Gjilan rr.”Abdullah Tahiri” nr.170, ndërsa aktvendimet e Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1198/23 dt.15.01.2024 dhe KPPP.nr.1198/23 dt.14.03.2024, VËRTETOHEN.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1198/23 dt.15.01.2024, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Andi Group 2004” shpk, me numër unik identifikues 81291046 me seli ne Gjilan rr.”Abdullah Tahiri” nr.170, ndërsa urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.104/23 dt.05.05.2023, të Përmbaruesit Privat Mubarak S. Shumolli Ferizaj e ka lënë ne fuqi. Me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1198/23 dt.14.03.2024, Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, e pjesën e I te dispozitivit është shpallë jo kompetente ne pikëpamje lëndore për te vendosur sipas kërkesës se debitorit “Andi Group 2004” shpk, me numër unik identifikues 81291046 me seli ne Gjilan rr.”Abdullah Tahiri” nr.170, për shtyrje te përmbarimit, ne lëndën përmbarimore P.nr.104/23 dt.14.03.2024 te Përmbaruesit Privat Mubarak S. Shumolli Ferizaj , ndërsa ne pjesën e II te dispozitivit e ka Hedhë poshtë si te palejuar

kërkesën e debitorit “Andi Group 2004” shpk, me numër unik identifikues 81291046 me seli ne Gjilan rr.”Abdullah Tahiri” nr.170, për shtyrje te përmbarimit ne lenden përmbarimore sipas urdhrin përmbarimor P.nr.104/23 dt.14.03.2024, i lejuar ngas Përmbaruesi Privat Mubarak S. Shumolli Ferizaj.

Kundër këtyre aktvendimeve, ka paraqitur ankesa debitori, për shkak te vlerësimit te gabuar te se drejtës materiale dhe gjendjes faktike si dhe ne lidhje me shpalljen jo kompetente ne pikëpamje lëndore e ne lidhje me shtyrje te përmbarimit, me propozim qe Gjykata e shkalles se dytë ti aprovoj këto ankesa, aktvendimet e gjykatës se shkalles se parë ti anuloj, urdhri përmbarimor te hedhet poshtë, te shtyhet përmbarimi ne periudhë prej 6 deri ne 10 muaj, te detyrohet kreditori ti kompensoj shpenzimet e procedurës përmbarimore ne vlerën prej 104 euro për përpilim te ankesës.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesat janë te pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Orchide Flower” shpk, me numër unik identifikues 811312727 me seli ne Prishtinë rr.” Richard Holbruk, më datën 05.05.2023, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit “Andi Group 2004” shpk, me numër unik identifikues 81291046 me seli ne Gjilan rr.”Abdullah Tahiri” nr.170, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr.20-210-002-022 dt.06.03.2022. Përmbaruesi Privat Mubarak S. Shumolli, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.104/23 dt.05.05.2023, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga fatura t’i paguaj shumën prej 125.00 euro, me kamatë prej 8% sipas LMD si dhe shpenzimet prej 78 euro sipas TAOK.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 05.06.2023, me pretendimin se kreditori ka shkelur rregullat e marrëveshjes për furnizim te produkteve ne te cilën kane parapare qe nga shitja debitori te përfitoj bonuse, se fatura nuk është e nënshkruar nga debitori dhe si e tillë është kontestueshme dhe e pabazuar pasi ne faturë është inkorporuar edhe zbritja nga bonusi qe e zberthen debitori ne diferencën e pagesës se obligimit te përmbushur ne tërësi te detyrimit financiar. Andaj nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin përmbarimor. Propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta hedh poshtë urdhrin përmbarimor dhe ta detyroj kreditorin ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore për përpilim te prapësimin prej 312 euro.

Debitori me datën 05.03.2024 ka ushtruar kërkesë për shtyrje te procedurës se përmbarimit duke iu referuar bazës ligjore nga neni 61 par.1 nenpar.1.1, par.4,8 dhe par.11 i LPP, me propozim qe gjykata e shkalles se parë ta aprovoj ne tërësi propozimin e debitorit për shtyrje te përmbarimit për

një periudhë kohore prej 6 deri ne 10 muaj nga dita e aprovimit te kërkesës ne shumen prej 125 euro për lenden P.nr.104/23 dt.05.05.2023.

Gjykata Komerciale e Kosovës –Dhomat e Shkalles se Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit dhe provave ne lëndë si dhe kërkesës për shtyrje te përmbarimit, ka nxjerrë aktvendimet KPPP.nr.1198/23 dt.15.01.2024 dhe KPPP.nr.1198/23 dt.14.03.2024 me të cilat ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimeve të atakuara. Gjykata me aktvendimin KPPP.nr.1198/23 dt.15.01.2024, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar, mbështetur ne nenin 29 par.1, nenpar.1.3 dhe par.3 te LPP si dhe nenit 37 te LPP sepse fatura mbi bazën e te cilës është lejuar përmbarimi përmban te gjitha elementet e kërkuara ne përputhje me kushtet për te qenë dokument i besueshëm pasi ne to janë treguar te dhënat e mjaftueshme për palët dhe objektin e çështjes si dhe kohen e përmbushjes, e njëjta është ne përputhje edhe me nenin 37 te LPP sepse është dorëzuar ne original dhe është pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitori . Sa i përket pretendimeve te debitorit ne prapësim gjykata gjeti se te njëjtat janë te natyrës materialo-juridike e te cilat janë objekt shqyrtimi ne këtë procedurë përmbarimore, e cila procedurë i nënshtrohet formalitetit rigoroz ku gjykata kufizohet vetëm ne vlerësim te elementeve formale te dokumentit, andaj edhe ka vendos si ne diapozitiv te aktvendimit.

Me aktvendimin KPPP.nr.1198/23 dt.14.03.2024, Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles se parë, pas shqyrtimit te kërkesës për shtyrje te përmbarimit ka vendosur si ne dispozitiv te aktvendimit. Gjykata me rastin e trajtimit te kërkesës se debitorit për shtyrje te përmbarimit ka gjetur se kjo kërkesë është e palejuar, e kjo bazuar ne nenin 61 par.1 dhe 4 te LPP nga te cilat dispozita del se kompetent për te vendosur ne lidhje me kërkesën e debitorit për shtyrje te përmbarimit është Organi Përmbarues përkatësisht Përmbaruesi Privat ndërsa përjashtimisht ne kuptim te nenit 61 pika 11 e LPP gjykata është kompetente ne rastet kur vepron si organ përmbarimor dhe ka juridiksion për te vendosur për ankesë kundër urdhrin për përmbarim, duke vendosur si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ne vendimin e saj KPPP.nr.1198/23 dt.14.03.2024, i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave te listuara ne propozimin për përmbarim të lëshuara nga kreditori e te cilat fatura plotësojnë kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.3 te LPP-së dhe si te tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit, sepse i përmbajnë elementet siç kërkohet me paragrafin 3 te këtij neni, i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shumat dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”* si dhe është ne pajtim me nenin 37 të LPP-së i cili thotë se *“kur propozimi për përmbarim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm,*

mjafton qe propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë ne original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Prandaj, bazuar ne këto arsye, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj te bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu qe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 te LPK dhe ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Edhe Gjykata e shkallës së dytë analizoi pretendimet ankimore te debitorit përkitazi marrëveshjes për furnizim qe kishin me kreditorin por këto pretendime kjo gjykatë i ka refuzuar si te pabazuara ndërsa pretendimin ankimor te debitorit ne lidhje me atë se kreditori ka shkelur rregullat e marrëveshjes për furnizim me mallra sa i përket përfitimit te bonuseve, kjo gjykatë i vlerëson si jo relevante sepse këto pretendime nuk hyjnë ne domenin e shqyrtimit ne këtë procedurë pasi parimi i rigorozitetit formal nuk lejon qe procedura përbarimore te lëshohet ne vlerësim te rrethanave tjera përpos vlerësimit te përshtatshmërisë se dokumentit mbi bazën e te cilit është lejuar përbarimi, ashtu qe te njëjtat i refuzoi si te pabazuara ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërtetoi.

Kjo gjykatë po ashtu vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt me rastin e vendosjes si ne aktvendimin e saj KPPP nr.1198/23 dt. 14.03.2024 për shpallje in kompetente dhe hedhje poshtë si te palejuar te kërkesës se debitorit për shtyrje te përbarimit. Përkitazi kësaj çështje edhe kjo gjykatë vlerëson nenin 61 par.1 te LPP i cili parasheh qe *“Në qoftë se debitori argumenton se zbatimi do t'i shkaktojë atij dëm të pariparueshëm, organi përbarues plotësisht ose pjesërisht do të shtyjë përbarimin kur: 1.1. është parashtruar ankesë kundër dokumentit përbarues dhe pala ankuese i demonstroi Gjykatës së shkallës së parë se ka mundësi bindëse për të qenë e suksesshme në ankesë, apo 1.2. Gjykatës i është parashtruar kërkesa për të anuluar një vendim të arbitrazhit në pajtim me Ligjin për Arbitrazhin”.*

Paragrafi 3 i këtij neni parasheh qe *“Para lejimit të shtyrjes së përbarimit, organi përbarues do t'i sigurojë kreditorit të drejtën që të deklarohet në lidhje me të dhe të jep dëshmi në kundërshtim të shtyrjes”.*

Paragrafi 4 i këtij neni parasheh qe *“Organi përbarues mund plotësisht ose pjesërisht ta shtyjë përbarimin në situata ku debitori.....”*

Paragrafi 8 i nenit 61 përcakton qartë se *“Organi përbarues vendos mbi një kërkesë për shtyrjen e përbarimit brenda pesë (5) ditëve nga marrja e saj”.* Andaj ne lidhje me këtë çështje dhe nga një gjendje e tille faktike ligjore si dhe ne pajtim me paragrafin 11 te nenit te sipër cekur, rezulton se kjo gjykatë pranon ne tërësi përfundimin juridik te gjykatës se shkallës së parë se organ

kompetent për të vendosur në lidhje me kërkesën e debitorit për shtyrje të përmbarimit është Organi Përmbarues përkatësisht Përmbaruesi Privat dhe jo Gjykata.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.999/24, me datë 29.11.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova